

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim servisi dhe pjesë këmbimi për mjetet e bashkisë ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

-09135000-4

-34330000-9

-42913400-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,666,600 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Prrenjas ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 30% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqitet kontrata e lidhur e shoqëruar me vërtetimin përkatës të lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Ose

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri përcaktohet se: Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë ne pronesi ose me kontrate qiraje të noterizuar një ambient servisi në territorin e Bashkisë Prrenjas, të pershtatshëm për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate.

Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumentave të cilat vërtetojnë pronesinë e objektit ose kontratën e qerasë të noterizuar të objektit të servisit. Në rastin e marrjes me qera të pikes së servisit të paraqitet dokumenti i cili vërteton pronesinë e objektit nga qiradhenesi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit për mjetet në rastet e difekteve nga adresa e autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Karrotrec	copë 1	në pronësi ose qira

Për këtë mjet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (Certifikatë e pronësisë, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit taksën vjetore (të vlefshme).

Në rastin e marrjes me qira, dokumentacioni i mësipërm të shoqërohet me kontratë noteriale të qirasë të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 4 /ç të nenit 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se : 4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që ka në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion të AK një automjet të përshtatshëm Karrotrec për transportin e mjeteve ,referuar specifikimeve teknike të hartuara nga komisioni .

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë 1 punonjës Mekanik i cili të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, si më poshtë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit;

- Liste pagesat për muajin e fundit të plotësuar rregullisht sipas formatit të përcaktuar që kerkohet nga legjislacioni në fuqi ;

- CV;
- Diplomë ose Çertifikatë;
- dhe Kontratë pune e rregullt.

Kërkesa e mesipërme mund të plotësohet nepermjet vetedeklarimit duke plotësuar tabelën e mëposhtme (në momentin e paraqitjes së dokumentacionit fizik do të paraqitet dokumentacioni provues):

Nr	Personeli	Emer Mbiemer	Data e lidhjes së kontratës
1	Mekanik		

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 4 /b të nenit 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se : 4. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;*

Me anë të këtij kriteri AK kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që ka në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion të AK një punonjës mekanik për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes dhe pjesëve të kembimit për mjetet e bashkise .

Argumentimi i specifikimeve teknike

Llogaritja e fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike janë hartuar nga grupi i punës i përaktuar me Urdhrin e Titullarit të AK.

Specifikimet teknike të objektit të prokurimit janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për shërbimin realizimit të aktiviteteve kulturore. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e “LPP”-i ndryshuar , si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”-i ndryshuar. Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë pjesë e dokumentave të tenderit

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit